



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:293237

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505492

E. nr. 365/09

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Astrit Gashi dhe bashkëpunëtorin profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të Kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a-Divizioni i Furnizimit, Bulevardi Bill Klinton, p.n – Prishtinë, kundër debitorit N.B, nga Gllogoci, lidhur me kompensimin e borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike, vlera e kontestit 3,578.27 €, duke vendosur lidhur me Propozimin e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme të datës 28.10.2020, jashtë seancës gjyqësore me datë 25.03.2024 e merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET poshtë si i pasafatshëm Propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme i debitorit N.B për shkak të humbjes së afatit për paraqitje të prapësimit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc për caktimin e përmbartimit me shenjë E. nr. 365/2009 të datës 04.11.2009.

A r s y e t i m

Debitori me datën 28.01.2020, i është drejtuar gjykatës me propozim që të lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme me arsyetim se i njëjti asnjëherë nuk e ka pranuar personalisht Aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit, dhe se njoftimin e parë lidhur me këtë çështje përmbartimore e ka marr ftesën e datës 10.01.2020, duke pretenduar se nuk është nënshkrimi i tij në fletëkthesën për pranim të aktvendimit të lartëcekur që mund të shihet nga tri nënshkrimet e tij duke pretenduar se sipas të gjitha gjasave nënshkrim ka dhënë personi tjetër, andaj i ka propozuar gjykatës që të lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme,

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të propozimit për përmbartim ka vërejtur se propozimi për përmbartim nga kreditori është parashtruar me datën 30.09.2009, ndërsa Aktvendimi me të cilin është caktuar përmbartimi është pranuar me datën 21.01.2010 nga vet debitori e që konfirmohet edhe me nënshkrim të dorëzuesit-zyrtarit të postës nën nënshkrimin e debitorit.

Neni 129 paragrafi 1 i LPK-së, ka paraparë që: *“Në qoftë se pala apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të*

kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.”

Neni 130 paragrafi 2 i LPK-së, ka paraparë që: *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”.*

Neni 131 i LPK-së ka përcaktuar se *"Nuk lejohet kthimi në gjendje të mëparshme nëse nuk është ruajtur afati për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme apo nëse pala nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme".*

Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshme të parapara me dispozitat e Nenit 129, 130 dhe 131 të LPK-së, kjo për faktin se në bazë të fletëdërgesës debitori e ka pranuar me kohë Aktvendimin për caktimin e përmbarimit dhe i njëjti nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për paraqitjen e prapësimit ku ka qenë i njoftuar me kohë për pasojat procedurale dhe ka pasur afat prej 7 ditësh si një afat i mjaftueshëm gjatë të cilës i njëjti ka mundur të gjejë mundësinë për kryerjen e një obligimi të tillë.

Andaj, sipas të cekurave më lartë e në kuptim të dispozitës së Nenit 129, 130 dhe 131 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
- Departamenti i Përgjithshëm, E. nr. 365/2009, datë 25.03.2024

Gjyqtari
Astrit Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.